



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, 30 shtator 2019
Nr.Ref.:RK 1435/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI67/19

Parashtrues

Hajrije Rina Zhitija Ajeti

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Themelore në Ferizaj, C. nr. 571/18, të 12 nëntorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Hajrije Rina Zhitija Ajeti nga Komuna e Ferizajt, të cilën e përfaqësojnë Teki, Ylli dhe Korab Bokshi, avokatë nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktgjykimin [C.nr.571/18] e 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), përmes të cilit është zgjidhur martesë në mes të saj dhe B.A.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të kontestuar, përmes të cilit parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit, nr. 03/L-121, për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 prill 2019, parashtruesja e kërkesës, nëpërmjet postës, e dërgoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 26 prill 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Safet Hoxha (anëtar) dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtare).
7. Me 3 maj 2019, përfaqësuesit e parashtrueses së kërkesës, dorëzuan autorizimin për përfaqësimin e parashtrueses së kërkesës në Gjykatë.
8. Më 22 maj 2019, Gjykata njoftoi përfaqësuesit e parashtrueses së kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

9. Me 22 maj 2019, Gjykata po ashtu njoftoi edhe Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj që të dorëzojë në Gjykatë një kopje të dosjes së plotë të lëndës në rastin e parashtrueses së kërkesës.
10. Më 11 qershor 2019, Gjykata pranoi një shkresë nga Gjykata Themelore, ku u njoftua që *‘dosja e lëndës [C.Nr.571/2018] me ankesë gjendet në Gjykatën e Apelit, prej datës 15 prill 2019 për shqyrtimin e ankesës.’*
11. Më 25 qershor 2019, Gjykata i dërgoi një shkresë parashtrueses së kërkesës përmes së cilës i kërkoj që ta njoftojë Gjykatën, nëse ka ushtruar ndonjë mjet juridik kundër Aktgjykimit [C.nr.571/18] të 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, përveç paraqitjes së kërkesës së tanishme para kësaj Gjykate.
12. Më 25 qershor 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoj nga ajo që (i) të dorëzojë një kopje të dosjes së lëndës përkatëse; dhe (ii) të informojë Gjykatën lidhur me statusin e të njëjtës.
13. Më 3 korrik 2019, parashtruesja e kërkesës e njoftoi Gjykatën që kundër Aktgjykimit [C.nr. 571/18] të 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelores, në Gjykatën e Apelit ka parashtruar propozimin për përsëritje të procedurës.
14. Gjykata e Apelit nuk iu përgjigj kërkesës së Gjykatës për dorëzimin e dosjes së lëndës.
15. Më 5 shtator 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

16. Më 9 shtator 2005, parashtruesja e kërkesës u martua me B.A.
17. Në një datë të pacaktuar, B.A., përkatësisht ish-bashkëshorti i parashtrueses së kërkesës, paraqiti padi në Gjykatën Themelore për zgjidhjen e martesës me parashtruesen e kërkesës, me arsyetimin se *“raportet bashkëshortore në fillim kanë qenë të mira por ndërkohë të njëjtat janë përkeqësuar deri në atë masë sa që jeta martesore është bërë e padurueshme”*.
18. Më 17 shtator 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr.571/18] caktoi avokatin M. Ll. si përfaqësues të përkohshëm ligjor të parashtrueses së kërkesës.
19. Me 12 nëntor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.571/18] aprovoi padinë e B.A-së dhe vendosi që të lejojë zgjidhjen e martesës me shkurorëzim.
20. Më 24 dhjetor 2018, Aktgjykimi i lartpërmendur i Gjykatës Themelore u bë i plotfuqishëm sepse ndaj tij nuk u ushtrua ankesë nga asnjëra palë në procedurë.

21. Më 16 mars 2019, sipas pretendimit të parashtrueses së kërkesës, ajo është vënë në dijeni për herë të parë për Aktgjykimin [C.nr.571/18] e 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, përmes të cilit ishte zgjidhur martesë e saj.
22. Më 28 mars 2019, parashtruesja e kërkesës, bazuar në pikat (a) dhe (c) të nenit 232 (Përsëritja e Procedurës) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK), parashtrroi propozim për përsëritje të procedurës pranë Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Deri më tani, nga shkresat e lëndës rezulton që Gjykata e Apelit akoma nuk ka vendosur lidhur me propozimin e lartcekur të parashtrueses së kërkesës për përsëritje të procedurës të dorëzuar në Gjykatën e Apelit më 28 mars 2019.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

24. Parashtruesja e kërkesës ndër të tjera pohon se (i) deri në vitin 2015, ka jetuar bashkë me bashkëshortin në Kanada, përkatësisht në adresën e të paditurës; (ii) përkundër faktit që bashkëshorti është kthyer në Kosovë, prej vitit 2015 deri me 2018, kanë mbajtur kontakte dhe bashkëshorti ka vizituar atë dhe vajzën e tyre në Kanada disa herë; (iii) në vitin 2018, përmes një mike të përbashkët, ka kuptuar se martesë e saj është zgjidhur përmes një Aktgjykimi të formës së prerë; (iv) deri në atë moment, ajo nuk ka qenë e informuar për asnjë procedurë përkitazi me zgjidhjen e martesës së saj; (v) bashkëshorti i saj së bashku me avokatin e tij si dhe përfaqësuesin e saj ligjor të caktuar nga Gjykata Themelore, kanë qenë në dijeni për adresën e saj në Kanada; dhe përkundër këtij fakti, (vi) përfaqësuesi i saj i caktuar nga kjo Gjykatë asnjëherë nuk ka tentuar ta kontaktojë dhe as nuk ka parashtruar ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore.
25. Ajo rrjedhimisht pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Themelore, përkatësisht Aktgjykimi [C.nr.571/18] i 12 nëntorit 2018, është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të saj themelore të garantuara përmes nenit 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
26. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesja e kërkesës pretendon shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe mospjesëmarrjes në shqyrtim gjyqësor. Parashtruesja e kërkesës në veçanti thekson se (i) nuk është thirrur në seancë në Gjykatën Themelore dhe rrjedhimisht nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore; dhe (ii) vendimi i gjykatës është bazuar në deklaratat e rreme të dëshmitarëve dhe dokumente të falsifikuara, në shkelje të pikës a) dhe c) të nenit 232 të LPK-së. Në mbështetje të pretendimeve të saj për shkelje kushtetuese, parashtruesja e kërkesës i referohet edhe Aktgjykimit të Gjykatës në rastin KI47/17 të 28 dhjetorit 2018, me parashtruese *Selvet Aliji* (në tekstin e mëtejshëm: Rasti KI47/17).

27. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që ta shpallë kërkesën e saj të pranueshme; të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 31 në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së; të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Themelore dhe të kthejë çështjen në rivendosje.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
29. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

30. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, që konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [C.nr.571/18] e 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore në Ferizaj.
31. Megjithatë, Gjykata vëren që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, gjithashtu përcakton detyrimin e shterimit të *“të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj”*. Ky detyrim kushtetues është gjithashtu i përcaktuar me paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës. Këto të fundit përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa Individuale]

[...]

2. Individ mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

“(1). Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(..)

"(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar."

32. Në këtë aspekt, Gjykata rithekson që paragrafi 7 i nenit 113 të Kushtetutës, paragrafi 2 i nenit 47 të Ligjit dhe pika (b) e paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës, ndër të tjera, qartë përcaktojnë detyrimin e *"shterjes së mjeteve juridike të përcaktuara me ligj"*, me kusht që një kërkesë të deklarohet e pranueshme dhe të shqyrtohen meritat e saj.
33. Kriteret e vlerësimit nëse ky detyrim është përmbushur, janë gjithashtu mirë të përcaktuara në praktikën e Gjykatës dhe atë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), në harmoni me të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
34. Arsyetimi i kërkesës për të shteruar mjetet juridike ose rregulli i shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, para së gjithash gjykatave të rregullta, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Ai bazohet në supozimin që pasqyrohet në nenin 32 [E drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës dhe në nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, se rendi juridik i Kosovës siguron mjet efektiv për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i karakterit subsidiar të makinerisë së drejtësisë kushtetuese. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, Aktgjykim i 28 korrikut 1999, paragrafi 74 dhe, ndër të tjera, shih rastet e Gjykatës nr.KI07/15, parashtrues *Shefki Zogiani*, Aktvendim për papranueshmëri i 8 dhjetorit 2016, paragrafi 61; KI30/17, parashtrues *Muharrem Nuredini*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 gushtit 2017, paragrafi 35; KI41/09, parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST ShPK*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 shkurtit 2010, paragrafi 16; dhe KI94/14, parashtrues *Sadat Ademi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 dhjetorit 2014, paragrafi 24).
35. Gjykata rithekson se kjo qasje kërkon që para se të drejtohen në Gjykatë, parashtruesit e kërkesës duhet të shterojnë të gjitha mundësitë procedurale, në procedura administrative ose gjyqësore, për të parandaluar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë ose, nëse ka, për të korrigjuar një shkelje të tillë të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI62/16, parashtrues *Bekë Lajçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2017, paragrafët 59-60; KI07/09, parashtrues: *Demë Kurbogaj dhe Besnik Kurbogaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 18-19; KI109/15, parashtrues: *Milazim Nrecaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2016, paragrafët 27-28; dhe KI148/15, parashtrues: *Xhafer Selmani*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 prillit 2016, paragrafët 27-28).
36. Megjithatë, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, përcakton edhe përjashtimet dhe kriteret mbi bazën e të cilave këto përjashtime mund të aplikohen, duke theksuar

se, rregulli i shterimit, duhet të zbatohet me një “*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*”, duke pasur parasysh kontekstin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. (Shih, në këtë kontekst, dhe ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI84/17, *Bahri Maxhuni*, Aktvendim për papranueshmëri i 31 majit 2018, paragrafët 25, 26 dhe 27).

37. Një ndër këto përjashtime, është mos detyrimi që individët, në parim, t'i shterojnë mjetet diskrecionale ose të jashtëzakonshme që i kanë në dispozicion. (Shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së, *Cinar kundër Turqisë*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2013 dhe *Prystavka kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2002; shih gjithashtu Udhëzuesin Praktik për Kriteret e Pranueshmërisë të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019, I. Bazat Procedurale të Papranueshmërisë, A. Mos-shterimi i mjeteve juridike, 2. Aplikimi i këtij Rregulli, e. Ekzistenca dhe Përshtatshmëria, paragrafi 77).
38. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren së parashtruesja e kërkesës pasi që është njoftuar me përmbajtjen e Aktgjykimit [C.nr. 571/18] të 12 nëntorit 2018 të Gjykatës Themelore, ka parashtruar propozim për përsëritje të procedurës pranë Gjykatës së Apelit, procedurë kjo që ende nuk ka përfunduar dhe është e regjistruar me shenjë [AC.nr.1846/19].
39. Gjykata tashmë ka përcaktuar në jurisprudencën e saj se nëse procedurat janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta atëherë kërkesa e parashtruesve konsiderohet e parakohshme. (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës, KI23/10, parashtrues *Jovica Gadzic*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 19 shtatorit 2013; KI32/11, parashtrues *Lulzim Ramaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 prillit 2012; KI113/12, parashtrues *Haki Gjocaj*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 25 janarit 2013, paragrafi 34; KI114/12, parashtrues *Kastriot Hasi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 3 prillit 2013, paragrafi 33; KI07/13, parashtrues *Ibish Kastrati*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 5 korrikut 2013, paragrafët 28-29; KI58/13, parashtrues *Sadik Bislimi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 nëntorit 2013, paragrafi 31; dhe KI102/16, parashtrues *Shefqet Berisha*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 2 marsit 2017, paragrafi 39).
40. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, bazuar në parimin e subsidiaritetit, Gjykata është e obliguar që kërkesën e parashtrueses së kërkesës të deklarojë si të papranueshme për shkak së është e parakohshme, duke u ofruar në këtë mënyrë mundësinë dhe përparësinë gjykatave të rregullta që t'i trajtojnë çështjet që ngritën në kërkesën e parashtrueses së kërkesës.
41. Gjykata thekson se rrethanat e rastit të parashtrueses së kërkesës dallojnë nga ato të parashtrueses së kërkesës në rastin e Gjykatës KI47/17. Përkitazi me këtë të fundit, Gjykata thekson se pas marrjes së Aktgjykimit [C.nr.280/2014] të Gjykatës Themelore, parashtruesja përkatëse kishte parashtruar propozim për përsëritje të procedurës në Gjykatë të Apelit. Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CN.nr.49/2016] të nxjerrë nga gjyqtari individual, e hodhi poshtë kërkesën e parashtrueses për përsëritje të procedurës. Më pas, parashtruesja e kërkesës kishte atakuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit

[AC.Nr.2812/2016], serish refuzoi si të pathemeltë ankesën e parashtrueses dhe e vërtetoi Aktvendimin [CN.nr.49/2016] e po të njëjtës gjykatë të nxjerrë në shkallë të parë. Përfundimisht, pas refuzimit të ankesës si të pathemeltë nga Gjykata e Apelit, parashtruesja paraqiti kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC.Nr.2812/2016] të 9 dhjetorit 2016 të Gjykatës së Apelit në Gjykatë. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit të referuar, parashtruesja e kërkesës i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike para gjykatave të rregullta, para se t'i drejtohej Gjykatës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar.

42. Gjykata në fund thekson se pavarësisht nga procedurat që janë në zhvillim e sipër tek gjykatat e rregullta dhe pa paragjykim ndaj atyre procedurave, asgjë nuk e ndalon parashtruesen e kërkesës që në të ardhmen sërish të dorëzojë kërkesë kushtetuese brenda afatit ligjor katër (4) muaj nga dita që e ka pranuar vendimin përfundimtar përkitazi me rastin e saj nga gjykatat e rregullta.
43. Rrjedhimisht, në këto rrethana, kërkesa e parashtrueses së kërkesës është e parakohshme dhe duhet të deklarohet e papranueshme, siç përcaktohet përmes paragrafi 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe specifikohet më tej përmes pikës (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës, me 5 shtator 2019, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Gresa Caka Nimani
Gresa Caka- Nimani

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi
Arta Rama-Hajrizi